

*“Deri sa mos ta ndryshojnë (pozitivisht)
gjendjen e tyre”*

VENDOSMËRIA NË FENË E ALLAHUT

Profesor:
Amr Halid

Për botuesin **ERIXH LIN-NESHRI**

Autor:

Prof. AMR HALID

Titulli i origjinalit:

الثبات على دين الله

Titulli:

VENDOSMËRIA NË FENË E ALLAHUT

Përktheu:

Dr. Musli VËRBANI

Korrektor:

Burim Bunjaku

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*

Mumin Shehu

Kaçanik

2006

Të drejtën e ribotimit e rezervon botuesi

Hyrje

Vërtet çdo falënderim i takon vetëm Allahut, prandaj ne vetëm Atë e falënderojmë, vetëm prej Tij ndihmë kërkojmë, nuk kërkojmë udhëzim tjetër pos çka na udhëzon Ai, Atij i kërkojmë falje, i mbështetemi Allahut nga të metat tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Cilin e udhëzon Allahu, ai nuk humb kurrë, mirëpo cilin e humb Allahu, për të nuk ka udhëzues.

Përshtëndesim dhe dërgojmë salavate për më të mirin e krijesave, më të zgjedhurin dhe më të ndriturin - robin e Allahut dhe të dërguarin e Tij - Muhamedin a.s.. Përshtëndesim edhe familjen e tij të mirë dhe të pastër, shokët e tij të mirë dhe të pastër në përgjithësi, dhe ata të cilët i pasojnë gjurmët e tyre me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

VENDOSMËRIA NË FENË E ALLAHUT

Çështja e vendosmërisë, me të gjitha format, është shumë e rëndësishme për çdo pjesëtar të umetit tonë, për t'ia kthyer umetit reputacionin, krenarinë dhe meritën, për të triumfuar ndaj armiqve, për të udhëhequr botën në punë të mira dhe lumturi në jetë.

Për fat të keq, shumica e kanë humbur këtë çështje dhe cilësi të lavdëruar. Sheh ndonjërin, i cili i përmbahet fesë, duke i kryer obligimet dhe duke u larguar prej mëkateve një periudhë kohore, kur papritmas, vëren se ai është larguar nga detyrat dhe obligimet e fesë! E gjithë kjo është shkak i pavendosmërisë dhe padurimit.

Një shumicë tjetër janë falur rregullisht, pastaj janë larguar nga namazi!

Një shumicë tjetër janë mbuluar me mbulesë islame në muajin Ramazan, pastaj prapë kanë vazhduar me avazin e vjetër, duke mos u mbuluar.

Në start ndjenjat e muslimanëve në fe janë në kulminacion, pastaj kohë pas kohe vjen përtacia dhe ftohja!

Armiqtë e islamit këtë e kanë kuptuar, e kanë kuptuar se fillimi të në është i flaktë, pastaj ftohemi dhe humb të ne vendosmëria, dhe me ne veprojnë sipas këtij rregulli. Pra, në fillim na lënë që të veprojmë çka të dëshirojmë, e pasi që të harxhohen forcat, atëherë veprojnë me ne si dëshirojnë ata.

Pse e gjithë kjo mangësi, a nuk ka mundësi që ndjenjat të vazhdojnë dhe të forcohen e të mos ketë mangësi dhe zbrazëti?!

Atëherë kur zbrazëtinë dhe mangësinë në zemrat tona e zëvendësojmë përgjithmonë ndjenjat dhe vullneti, atëherë kjo quhet vendosmëri.

Kur të flasim për përqendrueshmërinë në shoqëri, kemi për qëllim vendosmërinë e Selefi Salih të sehabëve, tabiinëve dhe kush i përmbahet atyre dhe vazhdon realizimin e planprojektit të tyre deri në Ditën e Kijametit.

Numri i sehabëve ka qenë i kufizuar në gadishullin arabik, mirëpo ata kanë qenë besimtarë të vërtetë dhe të vendosur, për këtë arsye ia kanë arritur qëllimit që fenë islame ta ndihmojnë, ta përforcojnë dhe ta përhapin.

Shpresoj se Allahu do të na bëjë të përqendruar në fenë e Tij, duke i kryer obligimet ndaj Tij e duke u larguar nga veprat e këqija dhe mëkatet, kështu që Allahu t'i ndihmojë fesë që të përhapet në gjithë rruzullin tokësor, që t'i ndihmojë umetit që të jetë i vendosur, t'i ndihmojë të vërtetës, ta eliminojë të pavërtetën. Shpresën e kemi te Ai, sepse ne jemi të dobët, por Allahu është i fuqishëm dhe te Ai kemi mbështetjen.

“NA MJAFTON ALLAHU, NUK KA MBROJTËS
MË TË MIRË”.

- HASBUNALLAHU VE NIËMEL VEKILË.

حسبنا الله و نعم الوكيل

PJESËT KRYESORE TË VENDOSMËRISË

Vendosmëria përbëhet prej tri pjesëve kryesore:

E para: Vendosmëria në drejtësi të përgjithshme;

E dyta: Vendosmëria në fenë e Allahut të

Lartmadhëruar;

E treta: Vendosmëria për t'i ndihmuar fesë.

SHEMBUJ TË ATYRE TË CILËT KANË SAKRIFIKUAR ÇDO GJË PËR ISLAM

Për të ndihmuar fenë islame duhet dhënë edhe më të çmuarën, pra jetën tënde.

Jeta jote duhet të jetë çështje e ndihmës së muslimanëve dhe ndihmesës së njerëzve për t'u kthyer në fenë e Allahut - Krijuesit të gjithë botëve.

Islami duhet të jetë më e çmuara në jetën tënde. Paraardhësit tanë fetarë të çmuar (selefuna salih) kanë jetuar, kanë thirrur në fe, kanë luftuar për të, dhe për ta mbrojtur atë. Për këtë kemi ilustrime të shumta, por ne do t'i paraqesim vetëm disa që të jenë shëmbëlltyrë për ne se si duhet jetuar me Allahun dhe për Allah, të përqendruar dhe të vendosur në fe.

* * *

AS-HABUL UHDUD

Transmeton Suhejbi se i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë: *Para jush ka qenë një mbret, i cili e kishte një magjistar. Kur magjistari e arrin pleqërinë, i thotë mbretit: Vërtet unë jam tepër në moshë, jam plakur shumë, andaj më dërgo një djalosh (të ushtrisë tënde) që t'ia mësoj magjinë. Ai ia dërgon një djalosh për ta mësuar magjinë.*

Djaloshi kur shkonte te magjistari në mes të rrugës e takon një mistik. Ulet pranë tij, bisedon për pak kohë dhe i pëlqejnë fjalët e tij. Kështu që ai e bën rregull, që çdo herë kur të shkojë te magjistari të ndalet te mistiku. Kështu që ai vazhdimisht vonohej. Kur shkonte i vonuar te magjistari, magjistari e rrihte. Ai ankohet te mistiku. Mistiku i thotë, pasi që frikësohesh se të rrahë magjistari thuaj atij më ka vonuar familja ime, e nëse frikësohesh prej familjes tënde thuaj se më ka vonuar magjistari.

Derisa ai vazhdonte mësimin , një shtazë e madhe i kishte bllokuar njerëzit. Ai thotë: Sot do ta kuptoj se a më i vlefshëm është mistiku apo magjistari! E merr një gur dhe thotë:

“O Zoti im, nëse veprimet dhe qëllimet e mistikut janë më të mira dhe më të dashura tek Ti se të

magjistarit, mbyte këtë shtazë prej duarve të mia dhe le të lirohen njerëzit. E gjuan gurin dhe shtaza mbytet dhe njerëzit lirohen.

Pas kësaj ngjarjeje shkon te mistiku dhe ia tregon ngjarjen. Mistiku i thotë: O djalosh, prej tani e tutje ti je më vlefshëm dhe më i ditur se unë . Por, unë kam një ndjenjë për ty se ti do të sprovohesh me një sprovë të madhe. E nëse sprovohesh mos më trego. Djaloshi i shëronte njerëzit me lloje të barnave të ndryshme prej sëmundjeve siç ishin: lepra, verbëria dhe prej çdo sëmundje tjetër. Një shok i mbretit ishte verbëruar. I verbëti kishte marrë shumë e shumë shpërblime dhe i thotë djaloshit: “Të gjitha këto shpërblime janë për ty vetë e vetëm nëse më shëron dhe më kthehet shikimi. Djaloshi i thotë: Unë nuk e shëroj askënd, por Zoti është Ai, i Cili shëron. Nëse ti beson në Zotin dhe i lutesh Atij Allahu do të të shërojë. Ai besoi në Zotin dhe Allahu e shëroi.

Ai shkon te mbreti ulet pranë tij, e mbreti e pyet: “Kush të shëroi dhe t’u rikthye shikimi?!” - Ai i përgjigjet: “Zoti im”!! - Mbreti i thotë: “A ka zot tjetër pos meje?!” – Ai i përgjigjet: “Zoti im dhe i yti është Allahu”. Mbreti i urdhëron parinë e tij për ta dënuar dhe maltretuar derisa detyrohet të tregojë për djaloshin. Shkojnë e marrin djaloshin, e sjellin para mbretit dhe mbreti i thotë:

“O djalosh, ti ke arritur në shkallë të lartë të aftësisë si magjistar, sa që po i shëron të verbrit dhe të zgjebosurit, dhe shëron e shëron ...”.

- Djaloshi i thotë: “Unë nuk e shëroj askënd, por Allahu shëron”. Pastaj mbreti e prangosë dhe e dënon, e maltreton derisa i tregon për mistikun. Shkojnë dhe e sjellin mistikun para mbretit dhe mbreti i thotë: “Largohu nga feja jote dhe kthehu në fenë tënde të mëparshme, idhujtar”. Ai refuzon. Mbreti urdhëron të marrin një sharrë, dhe ia aktivizojnë sharrën në qafë dhe e ndajnë në dysh. Pastaj e marrin ish shokun e mbretit dhe i thonë: “Largohu nga feja jote dhe kthehu në fenë tonë”. Ai refuzon. Ia vendosin sharrën në qafë, kështu që edhe atë e ndajnë në dysh. Pastaj e marrin djaloshin dhe i thonë: “Largoju nga feja jote”. Ai refuzon. Mbreti iu thotë disa shokëve: “Merreni dhe dërgojeni në një kodrinë të lartë dhe nëse largohet nga feja e tij kthejeni të shpëtuar, e nëse jo, hidheni”. Kur arrin në lartësinë më të madhe, ai thotë: “O Zoti im! Vepro si të duash!”. E hodhën prej lartësisë më të madhe të kepit, ndërsa ai pa kurrfarë lëndimi, në këmbët e tij, shkon te mbreti. Mbreti i thotë: “Si kanë vepruar shokët? - Ai i thotë: “Më ka mjaftuar Allahu, i Cili më ka shpëtuar”.

Pastaj iu thotë disa tjerëve: “Merreni, hipeni me një anije dhe kur të arrini në mes të detit pyeteni, nëse largohet prej fesë së tij kthejeni, e nëse jo, hidheni në det”. Ata shkuan. Ai prapë (para se të hidhej në det) thotë: “O Zoti im, vepro si të duash!”. E hedhin prej anijes për ta fundosur. Ai në këmbët e tij, pa kurrfarë lëndimi shkon te mbreti dhe i thotë mbreti: “Si kanë vepruar shokët e tu me ty?” - Ai i përgjigjet: “Më ka mjaftuar Allahu”. - Djaloshi i thotë mbretit: “Ti nuk mundesh të më mbytësh derisa të veprosh çka të urdhëroj unë”. – Mbreti i thotë: “Po çka është ajo?” – Djaloshi i thotë: “Ti tubosh njerëzit në një vend të më kryqëzosh, të më lidhësh për një lis, pastaj ta marrësh një shtizë, ta vendosësh në hark, e pastaj ta tërheqësh shtizën duke thënë: Në emër të Allahut, i Cili është Zot i djaloshit, pastaj të gjuash. Nëse vepron kështu, ke për të më mbytur”.

Mbreti i tuboi njerëzit në një vend dhe e lidhi djaloshin për një trup të një lisi, e mori shtizën, e vendosi në hark dhe tha: Në emër të Allahut, Zotit të djaloshit, dhe e hodhi shtizën. Shtiza i bie në kraharor, e ai e vendosi dorën në shtizë dhe vdiq.

Për këtë arsye njerëzit thanë: Besojmë në Zotin e djaloshit! Besojmë në Zotin e djaloshit! Besojmë në Zotin e djaloshit!

Shkojnë dhe i thonë mbretit: “A po e sheh çka po thonë? Prej Zotit po të tërhiqet vërejtja. Njerëzit, populli veç ka besuar”. Mbreti urdhëroi të hapej një hendek dhe në mes të hendekut të ndizej një zjarr i madh, dhe thotë: “Kush nuk kthehet prej fesë së tij hidheni dhe ashtu ndodhi. Derisa i vjen radha një gruaje, e cila e kishte fëmijën e saj në gjë. Asaj i vjen shumë vështirë për shkak të foshnjës së saj. Foshnja: i thotë nënës: Oj nëna ime, duro se nuk ka dyshim se ti je në rrugë të drejtë”.

(Sahihul Muslim, 5327)

Nga ky tregim madhështor përfitohet:

Angazhimi i djaloshit për të përfituar dituri, e cila sjellë dobi edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër, duke u mbështetur në fenë e të devotshmit (mistikut).

Përkundër asaj se djaloshi ka qenë i urdhëruar për të mësuar magjinë nga magjistari, atë nuk e ka konsideruar të mjaftueshme, por i ka bashkuar dy dituri për të kërkuar të vërtetën, kështu ai magjinë e mësonte prej magjistarit, ndërsa në të njëjtën kohë e mësonte fenë prej dijetarit të devotshëm mistik.

Djaloshi u angazhua për ta gjetur të vërtetën me studim se a është e vërtet magjia apo feja, se

Zoti ia lehtëson rrugën atij, i cili dëshiron për ta gjetur apo angazhohet për rrugën e drejtë.

Allahu i Lartmadhëruar ia ka lehtësuar djaloshit për ta kuptuar se njeriu i devotshëm është fetar, ai është i drejtë dhe ajo (feja) është çka e kënaq dhe e qetëson atë, ndërsa magjistari me magjinë e tij e shpie në humnerë dhe në atë çka nuk është i kënaqur.

Dijetari i cili thërret në rrugën e Allahut me sinqeritet është më i mirë se Allahu se sa ai i cili nuk thërret në rrugën e Allahut të Lartmadhëruar. I devotshmi i thotë djaloshit: - *“O djalosh, sot je më i mirë se unë, sepse po e shoh se i ke marrë çështjet me seriozitet”*. Sepse i devotshmi e ka ditur veten se ka heshtur dhe nuk ka thirrur në rrugën e Allahut, por është izoluar nga njerëzit dhe nuk i ka tërhequr për dore në rrugën e Allahut të qëndrueshme, ndërsa djaloshi ka thirrur në të vërtetën me diturinë të cilën e ka marrë prej të devotshmit (mistikut).

A e dini se pse na ka treguar Pejgamberi s.a.v.s. këtë ngjarje?!

- Që të jetë islami tepër i dashur për ne, i vulosur në zemrat tona, për të sakrifikuar çdo gjë në jetën tonë, çka do që të jetë, por edhe në qoftë se është në pyetje edhe vet jeta.

- Djaloshi nuk ka qenë pejgamber, mirëpo ka qenë rob i Allahut, i singertë, i pastër dhe i vendosur në rrugën e drejtë të Allahut.

- Djaloshi ka qenë tepër i vendosur dhe është mbështetur vetëm në Allahun e Lartmadhëruar. Kjo paraqitet me singëritetin dhe çiltërsinë e tij, duke iu lutur Zotit të tij, dhe bindjen e plotë të tij se magjia nuk bën as dëm, as nuk sjellë dobi. Ai ka qenë i bindur se ai, i cili shëron është vetëm Allahu i Lartmadhëruar.

- Besimi i djaloshit, të cilën e ka përfutur me diturinë fetare. Besimin e tij dhe se duhet thirrur njerëzit në besim dhe afrimin e tyre në fe. Kjo paraqitet atëherë kur ia ka arritur qëllimit të ikë dy herë, mirëpo ai ka dëshiruar të përhapë diturinë e tij, ka dëshiruar të përhapë fenë dhe për atë arsye më tutje nuk ka ikur, por ka dëshiruar të sakrifikojë veten e tij vetëm e vetëm që të përhapet feja e Zotit të Lartmadhëruar.

Mësimi kryesor të cilën treguam nga ngjarja është vendosmëria në fenë e Allahut, përkundër përndjekjeve, torturimeve dhe vrasjeve. Kjo kuptohet nga vendosmëria e mistikut, shokut të mbretit, djaloshit dhe Es-habul Uhdudit.

Vëlla!

Falënderojmë Allahun se ne jetojmë në vendin tonë një jetë të mirë dhe të qetë, me njerëz të mirë, me zemra të shëndosha, mirëpo ekziston një mjegulli dhe pluhur të cilat mund të eliminohen me butësi, dhe fjollat të cilat mbulojnë zemrat e tyre të pastrohen.

Çdo musliman duhet ta rrënjosë këtë ngjarje në zemrën e tij dhe të vazhdojë jetën e tij, dhe çdo herë kur t'i paraqitet ndonjë pengesë le t'i kujtojë këta besimtarë të vendosur, të cilët kanë qenë të bindur dhe me vendosmëri e kanë mbrojtur fenë e Allahut, dhe rrugën e drejtë të Tij.

* * *

NGJARJA E HUBEJBIT DHE VENDOSMËRIA E TIJ NË RRUGËN E ALLAHUT

Ebu Hurejrete r.a. transmeton se:

I Dërguari i Allahut ka dërguar në një mision dhjetë vëzhgues. Udhëheqës të tyre ka caktuar Asim bin Thabit el-Ensarijun – gjyshin e Asim bin Umer bin el-Hatabit derisa ishin në Hedete, vend, i cili ishte në mes të Asfanit dhe Mekes. Ia tregojnë atij një ngushticë (rrugë) për Hudhejlit, e cila rrugicë quhej Benul Hajan. Kundër tyre janë përgatitur përafërsisht 100 sulmues, të cilët i kanë përcjellë, deri sa në një vend i kanë parë mbeturinat e hurmave ku kishin ngrënë dhe kishin pushuar. Ata e kanë kuptuar se ishin hurmat e Medinës dhe me të shpejt kanë pasuar rrugën në drejtim të tyre. Kur Asimi me shokët e tij i hetuan ishin fortifikuar në një vend. Ata pastaj i rrethuan dhe iu thanë: Zbritni dhe dorëzohuni, se asnjërin prej jush nuk do ta vrasim, për këtë edhe japim besë. Asim bin Thabiti u thotë: O populli im, shokë të mi, unë nuk do të zbres që të bëhen pre e pabesimtarëve. Pastaj është lutur: “O Zoti im, lajmëroje për këtë peygamberin Tënd, Muhamedin a.s..

Gjuajnë me shtizë dhe e vrasin Asimin, ndërsa tre shokët e tjerë dorëzohen pasi që marrin besë prej tyre, e në mesin e tyre ishte Hubejbi Zejd bin Dethineti dhe një shahbe tjetër.

Kur iu afrohen idhujtarëve, ata ua lidhin duart e tyre. Shahbiu i tretë tha: Kjo është tradhtia e parë. Unë nuk do të dorëzohem, do të luftoj deri sa të vdes, dhe vazhdoi deri sa e therën dhe e mbytën. Kështu Hubejbin dhe Zejd bin Dethinetin i robëruan dhe i shitën pas luftës së Bedrit. Hubejbin, rob të zënë, e blenë Benu Harith bin Amir bin Nufel, ndërsa gjatë luftës së Bedrit Hubejbi e kishte vra Arith bin Amrin. Hubejbi qëndroi rob te ata deri në caktimin e datës së ekzekutimit të tij. Vajzat e Harithit e kanë huazuar një thikë për ta ekzekutuar Hubejbin.

Një fëmijë i vogël, i njërës vajzë së Amrit, e kishte marrë thikën pa dijen e saj dhe kishte shkuar te Hubejbi pa e ditur ajo, dhe ishte ulur në prehër të Hubejbit.

Ajo tregon se kur ka shkuar dhe e ka gjetur ulur në prehrin e tij, ndërsa thikën e kishte në dorë. Tregon ajo se është frikësuar për së tepërmi, sa që edhe Hubejbi e ka hetuar, pastaj e ka pyetur: A mos po frikohesh se do ta kisha mbytur?! Nuk do ta kisha bërë kurrë atë çka po mendon.

Ajo tregon: Për Zotin, kurrë nuk kam parë rob më të mirë se Hubejbi. Për Zotin, një ditë e kam parë duke ngrënë rrush, ndërsa ai gjithmonë ka qenë në pranga të hekurta, kurse në Meke nuk ka pasur aso pemë e fryte! Ajo thoshte: Ka qenë furnizim me të cilin e furnizonte Allahu Hubejbin.

Kur e nxorën, që në oborrin e Qabes ta ekzekutonin, Hubejbi iu thotë atyre: Më jepni rast që t'i fali dy rekate. E pasi e fali namazin tha: Për Zotin, po mos të mendonit se jam duke iu frikësuar vdekjes do t'i falsha më gjatë. Pastaj tha: - O Zoti im, tuboj të gjithë ata dhe zhduki për njëherë, dhe pastaj ka thënë:

*"Nuk brengosem kur të vritem si musliman,
Pa marrë parasysh se si vritem,
Sepse do të kthehem te Allahu, ashtu si dëshiron Ai,
E bekon mënyrën se si shkoj te Ai.*

Pastaj është ngritur Ebu Sirveate Ukbete bin el-Harith dhe e vret.

Kështu Hubejbi e ka treguar rrugën se si muslimani kur të vritet, të vritet i durueshëm dhe me namaz.

Vëlla!

Përkujtoje përqendrueshmërinë e Hubejbit r.a.
Analizo fuqinë e bindjes së tij në Allahun e
Lartmadhëruar dhe përqendrueshmërinë e tij në fe
edhe pse ishte i zënë rob dhe vritej.

Zgjidh Habibin r.a. dhe të tjetër besimtarë të
cilët kanë qenë të vendosur si ai. Le të jenë
shëmbëlltyrë për ty ata, të cilët kanë qenë të
vendosur në rrugën e Allahut dhe të Dërguarit të
Tij.

Paso ata dhe bëhu besimtar i sinqertë dhe i
mirë, mos i paso ata, të cilët janë lakmues të kësaj
bote. Bëhu si të devotshmit, sepse nëse bëhesh i
devotshëm do të jesh i fisnikëruar dhe do të korrësh
fitore.

Transmeton Habab bin Ereti se kemi shkuar
te i Dërguari i Allahut s.a.v.s., deri sa ai ishte i
mbështetur dhe qëndronte nën hijen e Qabës, e i
thamë atij:

*- A nuk po e lut Allahun që të na ndihmojë?
Muhamedi a.s. na tha:*

“Ka ndodhë para jush kur njerëzve u hapej varri dhe me sharrë ua sharritnin dhe ua përgjysmonin kokat e tyre, ndërsa ata nuk largoheshin kurrsesi nga feja; i ngujonin dhe i ngulitnin me gozhda në eshtrat e tyre, ndërsa ata nuk largoheshin nga feja e tyre.

Për Zotin, ndihma e Zotit do të vjen, sa që këmbësori do të ecë i lirë prej Sanasë deri në Hadremevt dhe nuk do t'i frikësohet askujt tjetër, pos Allahut. Ashtu do të jetë sa që as ujku nuk do t'i prekë dhentë, por ju po hezitoni”.

(Sahihul Buhari, 3343)

**** * ****

NGJARJA E FRIZERES PRIVATE (FLOKTARES) SË VAJZËS SË FIRAUNIT

Edhe pse kjo ngjarje ka transmetim të dobët, unë po e përmendi vetëm për të sjellë guxim dhe vendosmëri në adhurim ndaj Allahut edhe nëse është në pyetje torturimi apo vrasja.

Transmeton Ibn Abasi se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Në Natën e Israsë dhe të Miraxhit, kur jam ngritur në një vend prej vendeve, e kam ndier një aromë të këndshme, dhe pyeta: O Xhibril, ç’është kjo erë e këndshme?! – Tha: Kjo është aroma e floktares së bijës së firaunit dhe bijve të vet (floktares). – E pyeta: Po çka ka qenë puna me të? – Ai tha: Derisa e krihte bijën e firaunit i bie krehri prej dorës së saj, e ajo prapë e merr prej toke dhe thotë “Bismilahi”. E bija e firaunit i thotë: - Thuaj me emrin e babait tim! – Ajo i thotë: Jo (me emrin e babait tënd), por me emrin e Zotit tim, Zotit tënd dhe Zotit të babait tënd. Pra, me emrin e Allahut.

– Ajo e pyet: A ke ndonjë Zot tjetër, pos babait tim? – Ajo iu përgjigj: Po. Ndërsa ajo i

tregoi firaunit, i cili e thërret atë dhe i thotë: - Oj filane (N.N.)! A ke Zot pos meje? Ajo i përgjigjet: - Po, Zoti im është edhe Zoti yt, Allahu i cili mbizotëron çdo gjë edhe në qiej.

Firauni urdhëroi që të ndizej një zjarr nën një kazan të madh i cili vlonte, pastaj i merr djemtë e saj dhe i gjuante një nga një. Ajo i thotë: - Kam një kërkesë. - Firauni i thotë: Cila është ajo kërkesë? - I thotë: Dëshiroj që t'i tubosh eshtrat e mia dhe të fëmijëve të mi në një qefin dhe të na varrosësh të gjithëve së bashku. - Këtë edhe do ta bëjmë (iu përgjigj firauni). Fëmijët e saj i hidhte në kazan një nga një, derisa i erdhi radha edhe fëmijës së saj në gji, dhe sikur për të u brengos për së tepërmi. Mirëpo fëmija në gji i thotë: "Oj nëna ime, hidhu në zjarr së bashku me mua se dënimi në dunja është shumë më i lehtë se dënimi i ahiretit"! Pastaj u gjuajtën me fëmijën e saj.

Katër fëmijë (në djep) kanë folur, e ato janë: Foshnja e frizeres së vajzës së Firaunit, Dëshmitari i Jusufit, Shoku Xhurejxh dhe Isa i biri i Merjemes".

Vështroni pra, çfarë vendosmërie në adhurim ndaj Allahut Një, i Cili nuk ka rival.

Vështroni pra, çfarë imani (besimi) të fortë në zemër dhe sinqeritet në vepër.

Vështroni pra, të gjitha këto sakrifica vetëm e vetëm për ta adhuruar Allahun Një, i Cili nuk ka as shok, as rival.

Vëlla!

Feja jote është feja e trupit tënd dhe gjakut tënd.

Vëlla!

Jam munduar të sqaroj disa çështje të përqendrueshmërisë në fenë e Allahut të Lartmadhëruar, duke i ilustruar me disa shembuj, ngjarje të njerëzve të cilët kanë treguar heroizëm në momente shumë të vështira. Kam shpresë se Allahu i Lartmadhëruar se domethënia e kësaj çështje ka depërtuar te ju. Përmbaju fesë dhe kërko mbështetje te Allahu i Lartmadhëruar.

Vëlla!!

Kërkohet prej nesh që të jemi të vendosur në adhurim ndaj Allahut. Të kryejmë çdo urdhër të Tij dhe të largohemi nga çdo ndalesë e Tij. Të lutemi me sinqeritet që Allahu t'u ndihmojë të gjithë vëllezërve tanë në çdo vend. Të lutemi që Allahu t'i zgjojë njerëzit dhe të thërrasin në rrugën e drejtë të Allahut.

Vëlla!!

Kam një porosi!!Thuani vazhdimisht:

“HASBUNALLAHU VE NIËMEL VEKILË”

حسبنا الله و نعم الوكيل

“NA MJAFTON ALLAHU,
NUK KA MBROJTËS MË TË MIRË”.

Me këtë lutje ta kujtojmë Allahun pandërprerë, që t’ia largojë umetit vështirësitë, fatkeqësitë dhe t’i ngritë lart ndaj kundërshtarëve dhe armiqve të tyre.

Transmeton Ibn Abuse se lutjen:

حسبنا الله و نعم الوكيل

“HASBUNALLAHU VE NIËMEL VEKILË” e ka thënë Ibrahim i a.s. para se të hidhej në zjarr, e po këtë lutje e ka bërë edhe Muhamedi a.s. kur:

الَّذِينَ قَالَ لَهُمُ النَّاسُ إِنَّ النَّاسَ قَدْ جَمَعُوا لَكُمْ فَاخْشَوْهُمْ
فَزَادَهُمْ إِيمَانًا وَقَالُوا حَسْبُنَا اللَّهُ وَنِعْمَ الْوَكِيلُ

“Atyre (shokëve të Pejgamberit) që dikush u tha: Populli (idhujtarët) është tubuar t’ju sulmojë, pra kini frikë! Ajo përkundrazi, ua shtoi edhe më shumë besimin e thanë: Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i miri”

(Suretu Ali Imran, 172)

(Sahih El-Buharij, 4197)

FALËNDEROJMË ALLAHUN ZOTIN E GJITHË BOTËVE!

*** * ***

LIBRAT E AUTORIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”.
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur'anit”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1. “Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (*Muhamed Sajim*)
2. “Islami dhe Politika” (*nga autori Jusuf Kardavi*)
3. “Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (*Abdurrezak Nufel*)
4. “Për Kushtetutën Islame” (*Dr. Muhamed Sejid Ahmed El Musejer*)
5. “Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (*Abduhu Abas El-Velidi*)
6. “Vlera e kohës” (*nga autori Amër Halid*)
7. “Vëllazëria muslimane” (*nga autori Amër Halid*)
8. “Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (*Amër Halid*)
9. “Pendimi” (*nga autori Amër Halid*)
10. “Pasojat e mëkateve” (*nga autori Amër Halid*)
11. “Vendosmëria në fenë e Allahut” (*nga autori Amër Halid*)
12. “Mjetet e vendosmërisë në fenë e Allahut” (*nga Amër Halid*)

Së shpejti do të dalin nga shtypi përkthimet nga Amër Halidi:

1. “Forca në Allahun;
2. “Shpresa”;
3. “Besimi dhe bindja e fortë në Allahun”;
4. “Shpresa Imani dhe veprimi”;
5. “Serioziteti” dhe
6. “Pozitiviteti”.

Përmbajta:

Hyrje	3
Vendosmëria në fenë e Allahut	4
Pjesët kryesore të vendosmërisë	6
Shembuj të atyre të cilët kanë sakrifikuar çdo gjë për islam	7
As-habul Uhdudë	8
Ngjarja e Hubejbit dhe vendosmëria e tij në rrugën e Allahut	15
Ngjarja e frizeres private (floktares) së vajzës së firaunit	20
Librat e autorit	24
Përkthimet nga gjuha arabe	25
Përmbajtja	26